


PROKURORIA PUBLIKE E QARKUT
PP.nr.310/99
Prizren, 11.09.2000



GJYKATËS SE QARKUT

PRIZREN

Në bazë të nenit 45 al.2 pika 3 të LPP, parashtroj

AKTAKUZËN

Kundër:

SAVA MATIQIT, i lindur më 25.01.1963 në Rahovec, nga babai [REDAKTUAR] nëna [REDAKTUAR] e lindur [REDAKTUAR], din shkrim e lexim, i pamartuar, me kombësi serbe, shtetas jugosllav, gjindet në paraburgim që nga data 27.12.1999.

SEPSE

Gjat konfliktit të armatosur në Rahovec në muajin korrik 1998 dhe në kohën e luftës në Kosovë prej datës 23.03.1999 gjer më datën 12.06.1999 në teritorrin e Komunës së Rahovecit dhe atë në fshatrat Krushë e madhe dhe Potoqani i Ultë, duke shkelur rregullat e drejtës ndërkombëtare ka zbatuar urdhërat që të kryhen sulmet mbi popullatën e pambrojtur civile, mundimet, sjelljet jonjerëzore duke aplikuar masat e frikësimit dhe terrorit, marrjen e pengjeve, dërgimi kundërligjor në kampe dhe burgosje tjera kundërligjore, detyrimi në punë të obligueshme, shkatërrimin dhe përvetësimin e pasurisë në përmasa të mëdha dhe kundërligjore e cila nuk është e arsyeshme për nevojat ushtarake, djegjet e shtëpive, plaqkitjet e pasurive të tundshme, e krejt këto të popullatës shqiptare, e në mënyrë që si antar i arradhës paramilitare të serbëve në Rahovec ka zbatuar urdhërat e antarëve tjerë për kryerjen e krimeve të lartpërme-

ndura i veshur me rrobe të policis të kamofluara i armatosur me pushkë automatike merr pjesë në likvidimin e 42 fshatarve të fshatit Krushë e madhe që ka ndodhur më datën 26 mars 1999 me që rast janë pushkatuar 42 persona, merr pjesë dhe i rraf popullatën dhe ate fshatarët e fshatit Potoqani i Ultë duke i maltretuar fizikisht dhe duke i plaqkitur, si: Xh [REDAKTUAR] A [REDAKTUAR], Q [REDAKTUAR], S [REDAKTUAR], H [REDAKTUAR] H [REDAKTUAR] H [REDAKTUAR] A [REDAKTUAR], I [REDAKTUAR] Z [REDAKTUAR] dhe S [REDAKTUAR] Z [REDAKTUAR] që të gjithë nga fshati Potoqani i Ultë Komuna e Rahovecit,

- kësodore kryen veprën penale krimi i luftës kundër popullatës civile nga neni 142 al.1 të LP të aplikuar sipas dekretit të UNMIK-ut.

Andaj,

PROPOZOJ

Që pranë asaj gjykate të caktohet dhe të mbahet seanca kryesore publike, në të cilin duhet ftuar:

- prokurorin publik të qarkut në Prizren,
- të akuzuarin Sava Matiq i cili gjendet në burgun e qarkut në Mitrovicë,
- dëshmitarët: A [REDAKTUAR] Z [REDAKTUAR], S [REDAKTUAR] H [REDAKTUAR], Xh [REDAKTUAR] A [REDAKTUAR], S [REDAKTUAR] Z [REDAKTUAR], Q [REDAKTUAR] S [REDAKTUAR], H [REDAKTUAR] A [REDAKTUAR], I [REDAKTUAR] Z [REDAKTUAR] dhe H [REDAKTUAR] A [REDAKTUAR] -me adresa sikurse në shkresat e lëndës.

Që ndaj të akuzuarit Sava Matiq të vazhdohet paraburgimi konform dispozitës së nenit 191 al.2 pika 1 dhe 4 të LPP.

Arësytim

Pas përfudnimit të hetimeve në lëndën penale të të akuzuarit Sava Matiq nga Rahoveci për shkak të veprës penale krimi i luftës kundër popullatës civile nga neni 142 al.1 të LPJ të aplikuar sipas dekretit të UNMIK-ut, është vërtetuar kjo gjendje faktike:

se në këtë qështje penale nuk është kontestuese fakti se këtu i akuzuari Sava Matiq si pjesëtar dhe paramilitar që ka vepruar në Komunën e Rahovecit së bashku me të akuzuarit tjerë dhe paramilitarët tjerë gjat konfliktit të armatosur që ka ndodhur në korrik të vitit 1998 ka qenë i veshur me rrobe popullore të kamofluara dhe pushkë automatike - snajper dhe në këtë cilësi duke i zbatuar urdhërat nga lart merr pjesë në rrafshin dhe plaqkitjen e popullatës të pambrojtur shqiptare në fshatrat e Komunës së Rahovecit, kështu që konkretisht merr pjesë në rrahjen maltretimin fizik dhe psikik dhe mundimin e fshatarëve dhe atë të [REDAKTUAR], A [REDAKTUAR], Q [REDAKTUAR], S [REDAKTUAR], H [REDAKTUAR], H [REDAKTUAR], A [REDAKTUAR], I [REDAKTUAR], Z [REDAKTUAR] dhe S [REDAKTUAR], Z [REDAKTUAR] që të gjithë nga fshati Potoqani i Ultë, pastaj më datën 23.mars 1999 gjat luftës në Kosovë merr pjesë direkte në masakrën e fshatarëve në fshatin Krushë e madhe ku janë masakruar dhe vrarë 42 fshatar të fshatit Krushë e madhe.

Kjo gjendje e këtillë faktike vërtetohet me dëshminë e dëshmitarëve A [REDAKTUAR], Z [REDAKTUAR], S [REDAKTUAR], H [REDAKTUAR], Xh [REDAKTUAR], A [REDAKTUAR], S [REDAKTUAR], Z [REDAKTUAR], Q [REDAKTUAR], S [REDAKTUAR], H [REDAKTUAR], A [REDAKTUAR], I [REDAKTUAR], Z [REDAKTUAR] dhe H [REDAKTUAR], A [REDAKTUAR], H [REDAKTUAR].

I akuzuari nuk e pranon kryerjen e veprës penale duke u mbrojtur se nuk ka marr pjesë në rrahjen e popullatës shqiptare dhe në masakrën që ka ndodhur në Krushë të madhe por thekson se ka qenë i mobilizuar dhe në kuadër të obligimeve që ka patur në punë i ka kryer punët e tija të përditshme, ka ndëgjuar mbi vuajtjet e popullatës shqiptare, mbi vrasjet, shpërnguljet, burgosjet mirëpo në të gjitha këto ai nuk ka marr pjesë, mbrojtja e këtillë e të akuzuarit është e pabazuar dhe në kundërshtim me provat dhe atë dëshmitë e dëshmitarëve të propozuar.

Në favor të pabazueshmërisë të mbrotjes të të akuzuarit Sava Matiq flasin dëshmitë e dëshmitarëve dhe atë nga dëshmia e dëshmitarit A [REDAKTUAR], Z [REDAKTUAR] nga Krusha e madhe vërtetohet fakti dhe rrethana se këtu i akuzuari më datën 26 mars 1999 kur fshatarët e fshatit Krushë e madhe janë larguar nga fshati në mal atëherë janë nda burrat nga grat dhe fëmijët dhe me atë rast një numër i fshatarëve nga paramilitarët serb është vra dhe masakruar e ndër ta që ka marr pjesë në këtë masakër ka qenë edhe i akuzuari Sava Matiq.

Nga dëshmit e dëshmitarëve dhe ate S [redacted] H [redacted], Xhe [redacted] A [redacted], S [redacted] Z [redacted], Q [redacted] S [redacted], H [redacted] A [redacted], I [redacted] Z [redacted] dhe H [redacted] A [redacted] H [redacted] që të gjithë nga fshati Potoqani i Ultë vërtetohet fakti dhe rrethana se përveq këtyre dëshmitarëve në fshatin Potoqan i Ultë ku ka vepruar përveq tjerëve i akuzuari Sava Matiq kanë qenë të maltretuar, të munduar, fizikisht të rrafur, të plaqkitur dëshmitarët dhe popullata tjetër shqiptare nga i akuzuari Sava Matiq i cili konkretisht duke i zbatuar urdhërat nga Beogradi dhe nga eprorët e tij ka marr pjesë në rrafjen dhe maltretimin e popullatës shqiptarëve, në mundimin e tyre dhe plaqkitjen e tyre në mënyra të ndryshme së bashku me paramilitarët tjerë.

Andaj, në bazë të një gjendje të këtillë të vërtetuar faktike, konsideroj se në veprimet e të akuzuarit Sava Matiq formohen të gjitha elementet qensore të veprës penale të kimit të luftës kundër popullatës civile nga neni 142 al.1 të LP, për të cilën vepër penale i njejt i është juridiko penalisht përgjegjës me që nuk egziston asnjë bazë juridike që kishte me e përjashtue apo zbut përgjegjësin e tij juridiko penale.

Përndryshe nga provat dhe dëshmit e dëshmitarëve të propozuar pamëdyshje vërtetohet fakti dhe rrethana se i akuzuari ka qenë paramilitar i veshur dhe i armatosur, ka vepruar konkretisht në fshatin Potoqani i Ultë dhe Krushë të madhe së bashku me paramilitarët tjerë, ka zbatuar urdhërat nga lart duke maltretuar popullatën shqiptare, duke e rrafur, duke e plaqkitur dhe duke e vrrar, në kundërshtim me rregullat e drejtës ndërkombëtare dhe ligjeve pozitive.

Konsideroj se aktakuza e jonë është e provuar dhe në lgijë e bazuar.

